

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



PROGRAMI MËSIMOR

MATEMATIKË

për klasën e II

Shkup, 2021

TË DHËNAT ELEMENTARE PËR PROGRAMIN ARSIMOR

Lënda mësimore	Matematikë
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	I detyrueshëm
Klasa	II (e dytë)
Temat/ fushat në programin mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • Numrat dhe numërimi • Gjeometria • Operacione me numra • Matja • Puna me të dhëna
Numri i orëve	5 orë në javë/ 180 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • Tabelë qindëshe me numra, korniza dhjetë, rreshti numerik, karta me numra, kartat e fjalëve dhe koncepteve, shirita bosh dhe vargje letre të pa numër, shirita numrash rrëshqitës, vargje numrash, numratore, vizatime, karton me simbole të printuara (<, >, =) , karton me thyesa, rrota me numra - shigjeta, grafiku me vlerën vendore të numrit, kube me numra dhe pa numra. • Tabelë e mençur (smart table), kompjuter. • Komplet formash 2D dhe 3D (plastike, metalike, magnetike, kartoni), gjeotabelë, forma letre dhe kube që lidhen me njëri-tjetrin, vizore, shabllon, metro, enë për matjen e vëllimit, peshore. • Sende të ndryshme matëse: gota, shishe, bokall, enë të shënuara me litra, shirita letre dhe pëlhure, peshore, orë (orë rëre, orë analoge me akrepat që nxënësi mund të lëvizë, orë digjitale), monedha dhe kartëmonedha të vizatuar nga 1, 2, 5, 10, 50 dhe 100 denarë, para të vërteta, çmime, etiketa. • Kutitë, enë, lodra, xhetonë dhe sende të tjera (kapakë, makarona, shkopinj druri, etj.) që do të ndihmojnë në numërim, laps, letër, vizore, gërshërë, ngjitës, lloje të ndryshme të materialeve për bërjen e ekzemplarëve (fije leshi, shirita gome, pe , varëse rrobash, kunja, shporta, plastelinë, fara, gjethe, guralecë etj.).
Normativi i kuadrit arsimor	<p>Mësimi i matematikës në klasën e dytë mund të kryhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Profesor i mësimit klasor, VII / 1 ose VI / 1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK; • Pedagog i diplomuar, VII / 1 ose VI / 1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK.

LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e mësimit të paraqitura në programin mësimor shpiejnë drejt përvetësimit të kompetencave në vijim të përfshira në fushat **Matematikë dhe Shkenca Natyrore** nga Standardet Kombëtare.

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund:</i>	
III-A.1	të përdorë një sekuencë veprimesh me numra të plotë, thyesa dhe numra dhjetorë, duke përfshirë kllapat;
III-A.2	të rrumbullaksojë numrat në një shkallë të caktuar saktësie;
III-A.13	të analizojë 3D forma nëpërmjet rrjeteve dhe projeksioneve;
III-A.15	të transferojë 2D forma, duke kombinuar translacionin, rrotullimin, simetrinë boshtore dhe ngjashmërinë;
III-A.18	të përdorë njësitet matëse (gjatësi, masë, volum, sipërfaqe dhe vëllim) në kontekste të ndryshme;
III-A.23	të interpretojë tabelat, grafikët dhe diagramet, të krahasojë rezultatet dhe të nxjerr përfundime për saktësinë e hipotezës;
III-A.27	të përdorë aplikacione matematikore për të zgjidhur situata të ndryshme problemore dhe për të testuar njohuritë.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
III-B.1	secili mund të mësojë matematikë nëse përpiqet mjaftueshëm;
III-B.2	njohuritë e matematikës zbatohen në shumë fusha të jetës së përditshme;
III-B.3	njohuritë e matematikës janë të nevojshme për përvetësimin e njohurive nga lëndët dhe disiplinat e tjera shkencore;
III-B.4	mësimi i matematikës mund të jetë argëtues dhe interesant.

Programi mësimor përfshin kompetencat përkatëse në fushat e mëposhtme transversale të Standardeve Kombëtare:

Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Shoqëria dhe kultura demokratike dhe Teknika, Teknologjia dhe Sipërmarrësia.

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre është i nevojshëm dhe efektiv përdorimi i TIK-ut për zgjidhjen e një detyre/problemi;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet atij/asaj, të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna digjitale, informacione dhe përmbajtje;
V-A.6	të vendosë qëllime për mësim dhe vetëzhvillim dhe të punojë për të tejkaluar sfidat që dalin gjatë rrugëtimit drejt arritjeve të tyre;
V-A.7	të përdorë përvojën e vet për të lehtësuar mësimin dhe për të rregulluar sjelljen personale në të ardhmen;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e tyre me të tjerët dhe

	duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informatë kthyesë dhe mbështetje për veten, por gjithashtu ta kthejë informatën në mënyrë konstruktive dhe të japë mbështetje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të propozojë, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat për të nxjerrë konkluzione dhe të marrë vendime racionale;
VI-A.3	të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet personale, të dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë ata me respekt edhe kur nuk janë dakord;
VII-A.1	të lidhin njohuritë nga shkencat me zbatimin e tyre në teknikë dhe teknologji dhe në jetën e përditshme.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme - lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e dikujt varen kryesisht nga puna që ai/ajo bën dhe rezultatet që ai/ajo arrin;
V-B.4	çdo veprim që ai/ajo ndërmerr ka pasojat për të dhe/ose mjedisin e tij/saj;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	bashkëveprimi me të tjerët është i dyanshëm - siç ka të drejtë të kërkojë nga të tjerët që t'i mundësojnë atij/asaj që të jetë i/e kënaqur me interesat dhe nevojat e tij/saj, ashtu ka përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tyre;
V-B.9	kërkimi i informatave kthyesë dhe pranimi i kritikës konstruktive shpiejnë në përparim personal në nivel individual dhe shoqëror;

REZULTATET E TË NXËNIT

<p>Tema: NUMRAT DHE NUMËRIMI Gjithsej: 45 orë</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. numërojë, lexojë dhe shkruajë numrat deri në 100; 2. krahasojë çiftet e numrave dyshifrorë dhe të përcaktojë vlerën vendore të shifrave në numra; 3. njohë dhe përdor numrat rendorë të paktën deri në numrin e dhjetë; 4. grupojë numrat çift dhe tek deri në 100. 	
Përmbajtjet (dhe konceptet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none"> • Numra deri 100 (numra, sasi, shifra) 	<ul style="list-style-type: none"> • Numëron nga 1 deri në 100 para dhe mbrapsht. • Numëron nga dy, katër, pesë dhe dhjetë grupe më të mëdha sendesh deri në 100. • Bën një vlerësim të arsyeshëm të numrit të sendeve deri në 100. • Vendos numrin dyshifror në boshtin numerik në të cilët shënohen dhjetëshet e plota. • Lexon dhe shkruan numrat deri në 100.
<ul style="list-style-type: none"> • Vlera vendore e numrave (njëshe, dhjetëshe, vlera vendore) 	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton shifra me vlerë vendore të njëshit dhe dhjetëshit në një numër të caktuar dyshifror. • Rrumbullakon numrat dyshifrorë në dhjetëshen e plotë më të afërt.
<ul style="list-style-type: none"> • Krahasimi i çifteve të numrave dyshifrorë (shenjat më e madhe se >, më e vogël se <) 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor terma më e madhe se ose më e vogël se, për të krahasuar dy numra dyshifrorë dhe tregon një numër ndërmjet tyre. • Shpjegon pse ka shkruar shenjat > dhe < kur krahason çiftet e numrave dyshifrorë. • Rendit numrat me madhësi deri në 100.
<ul style="list-style-type: none"> • Numrat rendor (numrat rendor) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpreh numrat rendorë në kontekste të ndryshme. • Shkruan numrat rendorë të paktën deri në dhjetë.
<ul style="list-style-type: none"> • Numrat çift dhe tek (çift, tek) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh numrat çift dhe tek deri në 100. • Dallon numrat çift dhe tek deri në 100. • Tregon numër për dy më i madh ose për dy më i vogël se një numër çift ose tek deri në 100. • Formon grup numrash për dy më të mëdhenj ose për dy më të vegjël nga një numër i caktuar deri në 100.

Shembuj të aktiviteteve

- Secili nxënës/nxënëse numëron sende të ndryshme nga mjedisi i afërt (klasa, oborri i shkollës) sipas udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi.
- Loja **Vlerësimi** . Qese të tejdukshme me sende të vogla (për shembull: makarona, guralecë, kokoshka, kubikë ...) vendosen në një vend të dukshëm në klasë. Nxënësit marrin fletë vetëngjithëse dhe shkruajnë emrin e tyre, afrohen te qeset dhe vlerësojnë sa sende ka në secilën prej tyre. Ata shkruajnë vlerësimin në fletën pranë emrit të tyre dhe e ngjitin pranë qeses. Duke numëruar sendet, ata përcaktojnë se kush ishte më i saktë në vlerësimin e tyre.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, numërojnë përpara, prapa dhe në drejtime të tjera në një pjesë të caktuar të tabelës me numra deri njëqind, duke vizualizuar shabllonet e sistemit të numrave (për shembull: 45 deri në 95, 60 deri në 87, 97 në 27, etj.).
- Secili nxënës/nxënëse numëron një grup të caktuar sendesh (p.sh.: shpatulla, shkopinj, makarona ...), duke u grupuar në grupe nga dy, katër, pesë, dhjetë, të vendosur sërish në një situatë loje të mbështetur nga strategjia matematikore (me numërim, numërim nga një numër më i vogël, numërim nga një numër më i madh).
- Arsimtari fillon lojën **cili numër mungon...**, lexon një seri numrash të mbushur pjesërisht që rritet ose zvogëlohet për 2, 4, 5 ose 10 dhe nxënësit e plotësojnë me numrat që mungojnë.
- Në boshtin numerik të vizatuar në oborrin e shkollës ose në dërrasë të bardhë në klasë, nxënësit vendosin një numër dyshifror në vendin e duhur midis dy dhjetësheve të plota fqinje.
- Nxënësit lexojnë numrat e tabelës qindëshe në të gjitha drejtimet dhe i shkruajnë me fjalë.
- Nga kartat e numrave të dhënë, nxënësit të ndarë në dyshe, formojnë numra dyshifrorë të cilët i emërtojnë dhe shkruajnë numrin me shifra dhe fjalë.
- Zgjidhja e një situatë problemore. Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup krijon vargje numrash dyshifrorë (për shembull: 55, 60, 65 ...) në të cilët vendosin një numër joadekuat - "ndërhyrës". Detyra e grupeve të tjera është të zëvendësojnë "ndërhyrësin" me një numër të përshtatshëm.
- Nxënësit luajnë lojëra matematikore (<https://www.splashlearn.com/place-value-games>): emërtojnë shifra me vlerën vendore të njëshit dhe dhjetëshit në një numër të caktuar dyshifror.
- Nxënësit, të ndarë në dyshe, në shiritin e numrave rrëshqitës përcaktojnë vlerën vendore të shifrave në numrat dyshifrorë. Më pas i shkruajnë numrat dhe i renditin sipas madhësisë.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin dy gota letre në të cilat janë shkruar shifra të ndryshme dhe vendosin gotat pranë njëra-tjetrës. Duke i kthyer gotat, ata fitojnë numra dyshifrorë që i shkruajnë dhe i renditin sipas madhësisë.

- Nxënësit luajnë lojëra matematikore (<https://www.splashlearn.com/s/math-games/round-2-digit-number-to-the-nearest-10>): rumbullakojnë numrat dyshifrorë me dhjetëshen e plotë më të afërt.
- Nxënësit kanë aktivitete në tabelën qindëshe (të vizatuara ose të formuara në dysHEME me numra plastikë të ngjitur). Tre nxënës marrin pjesë në lojë, dy nxënës janë "dhjetëshet e plota", dhe një nxënës është një "numër" që ai do të zgjedhë dhe do të qëndrojë mbi të. Nxënësit e tjerë shohin se cila dhjetëshe është më afër numrit konkret dhe njëherit rrethojnë numrin dyshifror me dhjetëshen më të afërt.
- Nxënësit në grupe kanë tre korniza nga dhjetë dhe rrahë me ngjyra sipas dëshirës së tyre. Përcaktohet një numër nga 10 në 30. Secili grup gjen dhe emërton çifte numrash, shuma e të cilëve është numri i kërkuar nga 10 deri në 30 dhe gjithashtu e paraqet atë me rrahët me ngjyra të kornizës dhjetë (p.sh. 17, çifti i tij deri në 20 është 3 ; numri 25 , dhe dyshja e tij deri në 30 është 5 etj.) Ky aktivitet mund të realizohet me "pjesë, pjesë, tërësi".
- Nxënësit zgjidhin një problem duke krijuar një tregim me figura të një krokodili që thërret numrat më të mëdhenj (simboli për shenjën më të madhe është goja e hapur e krokodilit dhe është gjithmonë përballë numrit më të madh).
- Lojë në oborrin e shkollës. Nxënësit grupojnë sende që i vendosin në rrahë dhe vendosin shenjën e nevojshme të krahasimit midis secilit rreth (të cilin mund ta vizatojnë me shkumës ose prej kartoni).
- Nxënësit, të ndarë në grupe prej 10 vetash, bëjnë gara në vrap në oborrin e shkollës. Derisa nxënësit nga një grup vrapojnë, grupi i dytë shkruan emrin e nxënësit dhe numrin rendor të mbërritjes në vijën e finishit në tabelë. Në fund, numrat rendorë shkruhen me fjalë.
- Nxënësit nxjerrin letra me numra nga një thes, lexojnë numrin dhe thonë nëse është çift apo tek dhe cilës dhjetëshe i përket.
- Nxënësit krijojnë një grup sendesh me të njëjtin numër elementesh që grupohen në dyshe. Një element i shtohet secilit grup veç e veç. Nxënësit dallojnë numrat çift dhe tek.
- Nxënësit, të ndarë në dyshe, marrin karta me numra, njëri nxënës i rendit numrat tek nga më i vogli tek më i madhi dhe tjetri nxënës i rendit numrat çift.

Tema: **GJEOMETRIA**

Gjithsej: **25 orë** (realizohen gjatë tërë vitit shkollor)

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. shënojë një pikë në drejtëz dhe tërheq një vijë të thyer;
2. përshkruajë 2D dhe 3D forma dhe të tregojë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre;
3. njohë vijën e simetrisë në 2D forma dhe në mjedis;
4. përdorë terma të përshtatshëm për të shprehur pozicionin, drejtimin dhe lëvizjen.

Përmbajtjet (dhe konceptet)

Standardet për vlerësim

<ul style="list-style-type: none"> • pika dhe drejtëza (pika, drejtëza, vija e thyer) 	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon pikën në drejtëz dhe jashtë saj. <ul style="list-style-type: none"> • Percepton se a i takon pika drejtëzës (i takon, nuk i takon). • Njeh vijën e thyer të hapur dhe të mbyllur. • Vizaton një vijë të thyer me vizore.
<ul style="list-style-type: none"> • 2D-forma (katrori, drejtkëndëshi, pesëkëndëshi dhe gjashtëkëndëshi) 	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton forma 2D. • Vizaton me ndihmën e shabllonit dhe formon forma 2D. • Përshkruan forma 2D sipas numrit dhe gjatësisë së anëve. • Zbërthen format 2D në forma të tjera 2D dhe organizon të reja nga format ekzistuese 2D.
<ul style="list-style-type: none"> • 3D-forma (kubi, koni, cilindri, topi dhe piramida) 	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton 3D forma (p.sh kub, katror, kon, cilindër, top dhe piramidë). • Emërton format 2D që përbëjnë format 3D. • Grupon forma 3D (për shembull: kub, kon, cilindër, top dhe piramidë) sipas më së shumti dy vetive.
<ul style="list-style-type: none"> • Vija e simetrisë dhe e simetria në mjedis 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh vijën e simetrisë në forma 2D dhe vizatimet e objekteve. • • Gjen një vijë simetrie duke palosur forma 2D në gjysmë e një të katërtën. • • Gjen simetrinë në 2D forma dhe vizaton vijën e simetrisë.
<ul style="list-style-type: none"> • Pozicioni, drejtimi dhe lëvizja (lëvizja, drejtimi, këndi i drejtë, e tërë, gjysma, çereku) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh të tërën, gjysmën, çerekun në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës dhe në drejtim të kundërt. • Emërton çerek rrotullimin në rreth si kënd të drejtë. • Ndjek dhe jep udhëzime për pozicionin, drejtimin dhe lëvizjen duke përdorur një shigjetë si simbol.
<p>Shembuj dhe aktivitete</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit, të ndarë në grupe, me ndihmën e një litari apo fije peri formojnë vija të hapura dhe të mbyllura, vija të drejta dhe vija të thyera. • Nxënësit, të ndarë në dyshe, me ndihmën e shkopinjve ose kruese dhëmbësh formojnë një vijë të drejtë, një vijë të thyer, një vijë të mbyllur të thyer dhe një vijë të hapur të thyer. • Nxënësit, të ndarë në dyshe, ngjitin pika plastelinë ose letre që i përkasin dhe pika që nuk i përkasin drejtëzave. • Nxënësit, të ndarë në grupe, përshkruajnë forma 2D . • Nxënësit, të ndarë në grupe, presin format e vizatuara 2D, më pas i ngjisin në një copë letër dhe krijojnë forma të reja, si: kështjella, 	

shtëpi, makina, lokomotiva.

- Nxënësit, të ndarë në dyshe, bëjnë modele të formave 2D në letër ose në një gjeotabelë dhe i përshkruajnë e emërtojnë ndërmjet veti.
- Nxënësit vizatojnë individualisht forma 2D duke përdorur vizore.
- Nxënësit bëjnë individualisht piramida me plastelinë dhe kruajtëse dhëmbësh dhe përshkruajnë se nga cilat 2D forma janë krijuar.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin modele të 3D formave dhe nëpërmjet diskutimit zbulojnë se prej cilave forma 2D janë të formuara.
- Nxënësit ndërtojnë 3D forma duke përdorur shkopinj dhe plastelinë.
- Një send me formë të përcaktuar 3D vendoset në një qese. Një nxënës prek sendin dhe përshkruan 3D formën. Nxënësit e tjerë përpiqen të gjejnë se cila formë është.
- Nxënësit fitojnë figura me simetri boshtore të kafshëve, sendeve, formave, numrave, shkronjave dhe në çift duhet t'i palosin në dyshe përgjatë vijës së simetrisë.
- Një nxënës lëviz në klasë ose jashtë në një rreth të vizatuar, ndërsa një nxënës tjetër jep udhëzime lëvizjeje duke përdorur termat rrotullim rreth një çerek ose gjysmë në drejtim të akrepave të orës.
- Nxënësit palosin një copë letre në gjysmë dhe më pas në një të katërtën. Më pas, këndi i drejtë i fituar vendoset mbi sende dhe vërejnë nëse ka apo jo kënd të drejtë në sipërfaqet specifike të sendeve në klasë.
- Nxënësit marrin një letër me ilustrime të shumë sendeve dhe përdorin një shigjetë për të shënuar (lidhur) objektet sipas udhëzimeve të dhëna për gjysmë dhe çerek rrotullimin.

Tema: **OPERACIONE ME NUMRA**

Gjithsej: **80 orë**

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. mbledh dhe zbret numrat deri në 100;
2. dyfishojë dhe përgjysmojë një numër dyshifror (dyfishimi nuk duhet të kalojë 100);
3. shumëzojë dhe pjestojë me 1, 2, 4, 5 dhe 10;
4. gjejë gjysma dhe të katërtat e formave dhe grupe të vogla sendesh deri në 40.

Përmbajtjet (dhe konceptet)

- Mbledhja dhe zbritja deri në 100 (mbledhësi, shuma, i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi)

Standardet për vlerësim

- Mbledh numër dyshifror me 10.
- Shkruan çifte dhjetëshe të plota shuma e të cilave është 100.
- Mbledh numër dyshifror me numër njëshifror pa kalim dhe me kalim.
- Mbledh numër dyshifror me numër dyshifror pa kalim dhe me kalim.
- Shpjegon se gjatë mbledhjes, mbledhësit mund t'i ndërrojnë vendet.
- Zbret 10 nga një numër dyshifror.
- Zbret çiftet e dhjetësheve të plota deri në 100.

	<ul style="list-style-type: none"> • Zbret numër njëshifror nga numër dyshifror. • Zbret numrat dyshifrorë. • Shpjegon, me shembull, se zbritja nuk mund të bëhet në asnjë mënyrë tjetër. • Shpjegon rolin e zeros në mbledhje dhe zbritje. • Përcakton numrin që duhet të jetë në vendin e shenjës kur mbledhet dhe zbritet deri në 100. • Zgjidh detyra tekstuale që përdorin veprime të mbledhjes dhe zbritjes.
<ul style="list-style-type: none"> • Dyfishimi dhe përgjysmimi i numrave deri në 100 	<ul style="list-style-type: none"> • Dyfishon numrat dyshifrorë nga dhjetëshe të plota deri në 50. • Përgjysmon numrat dyshifrorë nga dhjetëshe të plota. • Dyfishon numrat dyshifrorë (dyfishimi nuk duhet të kalojë 100). • Përgjysmon numrat dyshifrorë. • Emërton çifte numrash me llogaritje, shuma e të cilëve është nga 10 në 30.
<ul style="list-style-type: none"> • Shumëzimi dhe pjesëtimi me 1, 2, 4, 5 dhe 10 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh numrat e fituar duke numëruar nga 1, 2, 4, 5 dhe 10. • Shkruan shumëzimin si shumë të mbledhësve të njëjtë. • Shumëzon numër njëshifror me 1, 2, 4, 5 dhe 10 dhe përdor shenjën „•“. • Grupi nga 2, 4, 5 dhe 10 për të numëruar një grup më të madh sendesh deri në 100 (pjesim me 2, 4, 5 dhe 10). • Shpjegon pjesimin si grupim dhe përdor shenjën "÷". • Pjeston me 2, 4, 5 dhe 10 pa mbetje dhe me mbetje. • Zgjidh detyra në të cilat përdor shumëzimin dhe pjesimin me 2, 4, 5 dhe 10
<ul style="list-style-type: none"> • Thyesa (e tërë, një gjysmë, një e katërta, dy të katërtat, tre të katërtat: $\frac{4}{4}, \frac{1}{2}, \frac{1}{4}, \frac{2}{4}, \frac{3}{4}$) • Gjysma dhe një e katërta e një grupi sendesh deri në 40 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh që një gjysmë shkruhet $\frac{1}{2}$, një e katërta $\frac{1}{4}$, dy të katërtat $\frac{2}{4}$, tre të katërtat $\frac{3}{4}$. • Njeh se cilat forma ndahen në gjysma ose katërshe dhe cilat jo. • Tregon gjysmat dhe të katërtat e grupeve të sendeve deri në 40. • Shpjegon se $\frac{2}{2}$ ose $\frac{4}{4}$ bëjnë një të tërë, ndërsa $\frac{1}{2}$ dhe $\frac{2}{4}$ janë të barabarta.
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit në nivel klase luajnë lojën Unë kam..., kush ka ...? Për shembull: "Unë kam numër 34, kush ka numër për 10 më të madh se 34?" • Çdo nxënës tërheq një kartë me një numër dyshifror të dhjetësheve të plota. Nxënësit ecin nëpër klasë duke kërkuar dyshen për të fituar një shumë prej 100. • Çdo nxënës nga tabela qindëshe zgjedh një numër dyshifror. Ndahen nxënësit në dyshe. Secili nxënës i shpjegon shokut të tij se sa dhjetëshe 	

dhe sa njëshe ka numri i tij. Në nivel klase diskutojnë për vlerën e shifrave të numrave dyshifrorë me dhjetëshe të plota.

- Nxënësit marrin një fletore pune me detyra në të cilat duhet të shtojnë një numër dyshifror me një numër njëshifror pa kalim. Çdo nxënës mund të përdorë një mënyrë të ndryshëm (numërimi përpara, zberthimi i një numri dyshifror etj.).
- Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grup merr një fletë në të cilën kanë për detyrë të mbledhin një numër dyshifror në atë njëshifror me kalim. Secili grup zgjedh mënyrën e vet të zgjidhjes (për shembull: $16 + 9 = ?$, $16 + 4 + 5 = 20 + 5 = 25$, shtim deri në dhjetëshe të plotë). Më pas përdoret teknika Karusel. Në shenjën e mësuesit, secili grup kalon deri te grupi tjetër (në drejtim të akrepave të orës) dhe mendon se si ta zgjidhë detyrën e tij, etj.
- Nxënësit punojnë në dyshe për detyra të ndryshme. Për shembull: në njërën dyshe njëri nxënës merr detyrat: $15 + 7$, $26 + 3$, $62 + 9$ dhe nxënësi tjetër merr detyrat: $7 + 15$, $3 + 26$, $9 + 62$. Diskutojnë në dyshe dhe vijën në përfundimin se rezultati është i njëjtë. Diskutimi zgjerohet në nivelin e klasës.
- Nxënësit shpejt thonë çifte numrash dyshifrorë nga dhjetëshe të plota, ndryshimi i të cilëve është, për shembull, 20.
- Nxënësit luajnë lojën në nivel klase: **Unë kam..., kush ka ...?** Për shembull: "Unë kam 97, kush ka numrin për 10 më pak se 97?" (Tabela qindëshe, duke numëruar prapa nga 10 ...).
- Nxënësit marrin fletore pune me detyra në të cilat duhet të zbresin një numër njëshifror nga një numër dyshifror (për shembull: $78 - 6$, $57 - 4$, $48 - 9$...). Çdo nxënës mund të përdorë mënyrë të ndryshme (tabela qindëshe - numërimi prapa, mjete ndihmëse, etj.).
- Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili grup merr një fletë pune me një detyrë tekstuale. Grupet zgjidhin detyrën e tyre, dhe më pas kalojnë nga një grup në tjetrin dhe në mënyrën e tyre zgjidhin detyrën nga fleta e grupit. Së fundi, ata diskutojnë mënyrat e ndryshme të zgjidhjes së secilës detyrë.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me detyra që kërkojnë prej tyre të zbresin numra dyshifrorë (për shembull: $38 - 24$, $87 - 36$, $47 - 29$, $64 - 28$). Arsimtari nxit nxënësit të sugjerojnë një mënyrë për të zgjidhur çdo detyrë (mund të jetë me kompensim, duke zberthyer numrin që zbritet etj.).
- Nxënësit punojnë në dyshe. Njëri nxënës merr detyra, për shembull: $15 - 7$, $26 - 3$, $62 - 9$, dhe nxënësi tjetër merr detyrat: $7 - 15$, $3 - 26$, $9 - 62$. Nxënësit vërejnë se renditja është e rëndësishme te zbritja.
- Nxënësit zgjidhin detyra tekstuale, si:
- Ana kishte 32 mollë, hëngri disa me shoqet e saj dhe mbeti me 23. Sa mollë hëngri?
- Më datë 28.01.2021 u zhvillua një kurs i shkurtër për kalimin e sigurt të këmbësorëve për fëmijët e klasës së dytë. Sa nxënës kanë munguar, nëse në shkollë ka 89 nxënës, prej të cilëve 78 nxënës kanë qenë prezent? Arsimtari inkurajon një diskutim të mënyrave për të zgjidhur secilën detyrë.
- Mësimdhënësi u jep nxënësve detyra të zgjidhura duke dyfishuar, përgjysmuar numra dyshifrorë nga dhjetëshe të plota dhe numra të tjerë dyshifrorë. Ata duhet të kontrollojnë përgjigjet dhe të shënojnë detyrat e zgjidhura saktë ose gabimisht.
- Nxënësit punojnë detyra me disa numra që nuk janë të njëjtë. Për shembull: Pesë fëmijë kishin gjithsej biskota: $2 + 1 + 3 + 1 + 3 = 10$. Më pas ata e zgjidhin detyrën kur të gjithë fëmijët kanë të njëjtin numër biskotash. Për shembull: Pesë fëmijë kishin gjithsej biskota: $2 + 2 + 2 + 2 + 2 = 10$. Arsimtari nëpërmjet diskutimit i ndihmon nxënësit të kuptojnë se ka edhe mënyrë tjetër për të shkruar llogaritjen e shumës kur të gjitha shumat janë të barabart, pra, $5 \cdot 2 = 10$.

- Nxënësit zgjidhin problemin: “Aliu ka 3 kuti me ngjyra druri. Në çdo kuti ka 4 ngjyra druri. Sa ngjyra druri ka Aliu?” Nxënësit mund të përdorin strategji të ndryshme (duke bërë tre grupe me katër fasule, duke përdorur letër në katror dhe duke ngjyrosur tre rreshta, ndërsa në çdo rresht të ngjyrosin nga katër katrorë, një matricë me pika VAN DE VALLE...).
- Nxënësit zgjidhin problemin: “Maja ka 35 shkumësa dhe i vendos në mënyrë të barabartë në 5 kuti. Sa shkumësa ka në secilën kuti?” (Disa nxënës mund të përdorin zhetonë, t'i rregullojnë ato një nga një në 5 grupe. Ata mund të vizatojnë pesë kuti dhe të vizatojnë një ngjyrë druri në secilën prej tyre derisa të fitojnë 35...)
- Për çdo tabelë (me 1, 2, 4, 5 dhe 10) nxënësit vendosin probleme në grupe. Më pas të dy grupet shkëmbejnë probleme dhe i zgjidhin ato.
- Nxënësit bëjnë gjysma dhe katërshe duke palosur letrën. E presin secilën pjesë, e emërtojnë dhe e shkruajnë (një gjysmë, një e katërta, dy të katërtat, tre të katërtat).
- Nxënësit bëjnë një pite ose picë me plastelinë ose brumë dhe e ndajnë në pjesë të barabarta dhe shohin të tërën, gjysmën dhe të katërtën.
- Nxënësit kanë dy gjysma pica. Ato vendosen pranë njëra-tjetrës për të treguar se dy gjysma bëjnë një të tërë, pra një picë. Pastaj bëjnë të njëjtën gjë me katër të katërtat e picës, duke u bashkuar fitojnë një picë të tërë, dmth arrijnë në përfundimin se katër të katërtat bëjnë një të tërë. Pyetja për nxënësit: Çfarë vëreni mes një gjysmë pica dhe dy të katërtat pica?
- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, marrin forma letre të rregullta dhe jo të rregullta, të cilat i palosin në gjysmë dhe dallojnë se cilat forma ndahen në gjysmë ose në një të katërtën dhe cilat jo.
- Aktivitete në dyshe. Nxënësit grupojnë sende (për shembull: spatula, shkopinj, makarona...). Numrin e sendeve e ndajnë në gjysmë. Çdo gjysmë të numrit përsëri e ndajnë në gjysmë. Vërejnë se cilët numra mund të ndahen në gjysma ose katërshe.
- Aktiviteti Gjerdan. Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepen fije dhe rruaza në tre ngjyra (10 të bardha, 5 të verdha dhe 5 të kuqe) për të lidhur rruazat dhe për të bërë një gjerdan, por mos përzihen ngjyrat. Nxënësit shohin $\frac{1}{2}$, $\frac{1}{4}$ e të gjithë gjerdanit.
- Nxënësit me shabllon vizore vizatojnë forma (katror, drejtkëndësh, trekëndësh, rreth) dhe përcaktojnë se cila formë mund të ndahet në gjysma dhe katërshe.
- Lojë *Memorie*: Nxënësit, të ndarë në grupe, lidhin çifte letrash (për shembull: një kartë me mbishkrimin $\frac{1}{2}$, ndërsa kartën tjetër me pikturë - gjysmë mollë).
- Nxënësit, të ndarë në dyshe, marrin një fletë me 2D forma të vizatuara të ndarë në katërshe. Nxënësi hedh një kub (me numrat 1, 2, 3 dhe 4) dhe numri që merr i tregon se sa pjesë të thyesës duhet të ngjyros. Emërton dhe shënon pjesët me ngjyra, thyesat. Percepton dhe lidh thyesat e barabarta $\frac{1}{2}$ dhe $\frac{2}{4}$.

Tema: **MATJA**

Gjithsej: **15 orë** (realizohen gjatë gjithë vitit)

Rezultatet e të nxënësve

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

<p>1. llogarisë mënyrën e pagesës së saktë të shumës deri në 100 denarë duke përdorur monedha 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë dhe kartëmonedha nga 10, 50 dhe 100 denarë;</p> <p>2. vlerësojë dhe të matë gjatësinë, masën dhe vëllimin duke përdorur njësi standarde;</p> <p>3. lexojë kohën nga ora dhe të rendit intervalet kohore të ditës, ditët e javës dhe muajt e vitit.</p>	
Përmbajtjaet(dhe konceptet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none"> • Para (monedha 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë dhe kartëmonedha 10, 50 dhe 100 denarë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh dhe emërton monedha dhe kartëmonedha deri në 100 denarë. • Grupon monedhat dhe kartëmonedhat sipas vlerës. • Përcakton shumën e saktë të parave duke shtuar ose zbritur monedha dhe kartëmonedha. • Thekson disa mënyra se si mund të paguhet një shumë e caktuar
<ul style="list-style-type: none"> • Gjatësia, masa, vëllimi (matja e gjatësisë, masës, vëllimit, centimetër, metër, kilogram, litër) 	<ul style="list-style-type: none"> • Mat gjatësinë, masën dhe vëllimin dhe shprehet në njësi standarde. • Vlerëson gjatësinë, masën dhe vëllimin dhe kontrollon rezultatet e vlerësimit me njësi standarde matëse. • Përdor njësitë standarde matëse për gjatësinë, masën dhe vëllimin në një kontekst real. • Krahason gjatësitë, masat dhe vëllimet dhe rendit rezultatet e krahasimit në varg. • Zgjidh situata problemore që përfshijnë gjatësinë, masën, vëllimin.
<ul style="list-style-type: none"> • Koha (minuta, orë, ditë, javë, muaj dhe vite, kalendar) 	<ul style="list-style-type: none"> • Lexon kohën në orë dhe minuta. • Rendit ditët e javës, muajt e vitit. • Përdor kalendarin dhe cakton intervalet kohore. • Vlerëson dhe mat se sa kohë i nevojitet për aktivitete të caktuara. • Zgjidh situata problemore që përfshijnë kohë.

Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit luajnë rolin e shitësve dhe blerësve duke përdorur para - monedha dhe kartëmonedha.
- Nxënësit duke hijëzuar bëjnë monedha, vizatojnë kartëmonedha dhe më pas i përdorin në aktivitete të ndryshme.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, bëjnë një shumë prej 100 denarë duke përdorur monedha dhe kartëmonedha të ndryshme dhe ua prezantojnë grupeve të tjera.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, matin gjatësinë e klasës me njësi matëse jo standarde dhe standarde. Ata krahasojnë rezultatet e dy matjeve dhe arrijnë në përfundimin se kur matja shprehet në njësi standarde matëse ata marrin të njëjtin rezultat.
- Nxënësit, të ndarë në dyshe, vlerësojnë se ku ka më shumë lëngje në forma të ndryshme enësh (enë të mëdha, të vogla, të gjera dhe të ngushta të tejdukshme) dhe matin vëllimin.
- Nxënësit, të ndarë në dyshe, vlerësojnë dhe krahasojnë se cili send ka masë më të madhe dhe cili send ka masë më të vogël dhe kontrollojnë rezultatet e marra duke matur.
- Nxënësit, të ndarë në dyshe, marrin një copë letër në të cilën vizatohen sende dhe produkte (p.sh.: një qese miell, një shishe vaj gatimi, qumësht në një kuti kartoni, një litar, një fjongo dekorative, etj.) dhe duhet ta shkruajnë nën çdo figurë njësinë e duhur matëse.
- Nxënësit përdorin një kalendar javor për të planifikuar aktivitetet e tyre gjatë një jave.
- Nxënësve u jepen detyra me situata problemore (për shembull: Sa orë kanë kaluar nga mesnata deri në mesditë? Sa orë janë në shkollë? Sa kohë ka kaluar nga mesdita deri në orën 18: ...).
- Çdo nxënës merr një orë dore të vizatuar. Nxënësit punojnë në dyshe ku njëri nxënës i sugjeron shokut të klasës në çift që të vizatojë akrepat e orës në orën 10, 17 e kështu me radhë. Aktiviteti mund të vazhdojë për të rritur grupet e nxënësve në 4, më pas në 8 dhe për të lexuar kohën nga orët e vizatuara.
- Nxënësit në një fletë zgjedhin një aktivitet të caktuar që duhet të realizojnë. Në fillim ata japin një supozim për sa kohë mund ta realizonin atë. Ata matin kohën e nevojshme për aktivitetin dhe në fund krahasojnë nëse kanë bërë një vlerësim të mirë.
- Nxënësit përdorin një orë për të matur kohën gjatë së cilës mund të lexojnë një tekst të shkurtër sipas dëshirës.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin karta për ditë dhe muaj dhe duhet t'i rregullojnë sipas renditjes në një shabllon kalendar.
- Nxënësit ndahen në grupe ku secili grup harton situata problemore për kohën, paranë, gjatësinë, masën dhe më pas i shkëmben mes tyre dhe i zgjidh. Grupi që ka përbërë detyrën kontrollon zgjidhjen e detyrës.

Tema: **PUNA ME TË DHËNA**

Gjithsej: **15 orë** (realizohen gjatë gjithë vitit)

Rezultatet e të nxënësve

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. lexojë të dhënat nga tabelat dhe diagramet;
2. mbledhë, rregullojë, paraqesë të dhënat në tabela dhe diagrame;

3. përdorë terminologjinë e lidhur me të dhënat.

Përmbajtja (edhe nocione)	Standarde të vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> Lexon të dhënat (tabelat, piktogramet, diagrami i Venit, diagrami i Karolit dhe diagrami me shtylla) 	<ul style="list-style-type: none"> Lexon të dhëna nga listat, tabelat, piktogramet dhe diagramet (i Venit, i Karolit dhe me shtylla) të renditura sipas një ose dy kriterëve. Lexon të dhëna nga piktogramet (me simbole që përfaqësojnë 2, 4, 5 ose 10 të dhëna). U përgjigjet pyetjeve rreth të dhënave nga listat, tabelat, piktogramet dhe diagramet (i Venit, i Karolit dhe me shtylla).
<ul style="list-style-type: none"> Grumbullon, rregullon dhe paraqet të dhëna nga mjedisi i afërt (të dhënat, tabela, listat, piktogramet, diagrami me shtylla, diagrami i Venit, diagram i Karolit) 	<ul style="list-style-type: none"> Mbledh të dhënat dhe i fut në lista dhe tabela të gatshme. Rregullon dhe paraqet të dhënat në një listë, tabelë, piktogram dhe diagram me shtylla. Paraqet të dhëna me piktogram, diagram të Venit, të Karolit dhe diagram me shtylla për renditjen e numrave dhe sendeve, duke përdorur një ose dy kriterë. Bën një zgjedhje dhe shpjegon zgjedhjen e kriterit / dy kriterëve, duke përdorur terminologjinë e duhur.

Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit punojnë në grupe. Secili grup ka një tabelë në të cilën të dhënat janë grupuar sipas dy kriterëve, për shembull: nxënësit e shkollës të renditur sipas gjinisë, sipas peshës. Lexojnë të dhënat nga tabelat dhe u përgjigjen pyetjeve lidhur me tabelat.
- Nxënësit lexojnë individualisht të dhëna nga një piktogram i dhënë dhe u përgjigjen pyetjeve (për shembull: Çfarë është më shumë? Çfarë është më pak? Sa është më shumë? Sa është më pak?).
- Klasa ndahet në grupe. Secili grup merr një tabelë, piktogram ose diagram me të dhëna. Nxënësit nga secili grup lexojnë të dhënat dhe më pas ua prezantojnë shokëve të klasës, duke përdorur terminologjinë e duhur.
- Nxënësit kanë të dhëna se sa nxënës ka në katër klasa të shkollës dhe sa nxënës në secilën klasë janë djem dhe sa janë vajza. Numri i përgjithshëm i djemve dhe vajzave përfaqësohet me një piktogram (me simbole që përfaqësojnë 2, 4, 5 ose 10 të dhëna).
- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin kartela me fruta dhe perime. Detyra e nxënësve është të grupojnë, numërojnë të dhënat dhe të zgjedhin mënyrën e paraqitjes së tyre (për shembull: në listë, tabelë ose piktogram).
- Nxënësit në nivel klase diskutojnë nëse të dhënat në tabelë (për shembull: 2D format; konsumi i vajit në muaj ...) mund të përfaqësohen me një piktogram, diagram me shtylla, diagramet të Venit dhe diagram të Karolit.
- Nxënësit mbledhin dhe renditin të dhëna (për shembull: "Heroi im i preferuar i lojës kompjuterike", "Këngëtarja ime e preferuar", "Dita e preferuar e anëtarëve të familjes", "Llojet e automjeteve me të cilat kemi udhëtuar", "Çfarë u pëlqen më shumë të bëjnë në shtëpi" etj.) dhe paraqesin të dhënat në tabelë dhe me diagram me shtylla.
- Nxënësit në diagramin e Karolit grupojnë numrat nga 1 deri në 20 sipas dy kriterëve: numrat çift dhe tek dhe dhjetëshja e parë dhe e

dytë.

- Nxënësit bien dakord të luajnë pikado me numra dhe të paraqesin të dhënat në një tabelë frekuencash.
- Në oborrin e shkollës vizatoht një vijë fillimi dhe një vijë fundi. Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi i parë shkruan të dhënat, ndërsa grupi i dytë realizon veprimtarinë e mëposhtme: secili nxënës në grup, duke filluar nga fillimi/starti, drejton dhe troket topin drejt qëllimit, ndërsa grupi tjetër numëron dhe shënon në tabelë kërcimet e topit. Më pas grupet ndryshojnë rolet. Në klasë, secili grup prezanton të dhënat e marra në një diagram me shtylla dhe më pas i paraqet ato.
- Aktivitet në oborrin e shkollës. Nxënësit vizatojnë diagrame të Venit. Ato grupohen sipas karakteristikave të caktuara, të dakorduara paraprakisht. Për shembull: këpucë të bardha, atlete në ngjyra të ndryshme etj. Ka një diskutim rreth kryqëzimit të diagramit. U kërkohet nxënësve të bëjnë sugjerime sipas të cilave do të grupohen.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, në banga bëjnë një diagram të Venit me fije peri dhe renditin objektet në rrrathët e diagramit sipas dy kriterëve (p.sh.: nga grupi i lodrave prej gome dhe nga grupi i kukullave të bëra nga materiale të ndryshme i ndajnë kukullat prej gome; nga grupi i kubeve dhe nga grupi forma të ndryshme 3D me ngjyrë blu veçojnë kubet blu etj.).
- Nxënësit kanë një listë me 30 familje që janë përgjigjur se sa kilogramë hanë nga pesë lloje frutash. Ata i rregullojnë të dhënat në një tabelë dhe regjistrojnë sa kilogramë gjithsej konsumohet nga çdo frut.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA GJINORE/NDJESHMËRIA, NDËRKULTURA DHE INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi e siguron gjithëpërfshirjen duke i përfshirë të gjithë nxënësit në të gjitha aktivitetet gjatë orës. Në këtë mënyrë ai/ajo mundëson që çdo fëmijë të jetë i angazhuar në mënyrë konjitive dhe emocionale nëpërmjet përdorimit të qasjeve të përshtatshme në mësimdhënie (individualizimi, diferencimi, puna në eki, mbështetja mes nxënësve). Gjatë punës me nxënësit me aftësi të kufizuara, zbatohet një plan arsimor individual (me rezultate të përshtatura të të mësuarit dhe standarde vlerësimi) dhe çdo herë kur është e mundur përdoret mbështetje shtesë nga individ të tjerë (asistentë personalë, ndërmjetësues arsimorë, tutorë vullnetarë dhe profesionistë nga shkollat e qendrave të burimeve). Vëzhgon rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata të grupeve të ndjeshme, në mënyrë që të jetë në gjendje të identifikojë vështirësitë e të mësuarit në kohën e duhur, për t'i inkurajuar dhe mbështetur ata në arritjen e rezultateve në mësimdhënie.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësimdhënësi trajton si djemtë ashtu edhe vajzat në mënyrë të barabartë, duke u kujdesur që të mos u caktojë atyre role stereotipike gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, bëhet një përpjekje për të siguruar ekuilibrin gjinor. Kur zgjidhin materiale shtesë në mësim, përdorin ilustrime dhe shembuj që janë të ndjeshëm ndaj aspektit gjinor dhe etnik/kulturor dhe inkurajojnë barazinë gjinore, gjegjësisht promovojnë ndërkulturën (për shembull: në detyrat tekstuale përdorin emra karakteristikë të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike dhe tregohet kujdes që personazhet e meshkujve dhe femrave të mos lidhen me role stereotipike gjinore).

Çdo herë kur është e mundur, mësuesi përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve në planifikimin dhe zbatimin e mësimit. Integrimi mundëson nxënësit të përfshijnë perspektivat e lëndëve të tjera në atë që mësojnë në këtë lëndë dhe të lidhin njohuritë nga fusha të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'iu mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësuesi vazhdimisht vëzhgon aktivitetet e tyre gjatë mësimit dhe mësimit. Mblidhen tregues për aktivitetet e tyre, motivimin për krijim artistik, angazhimin e nxënësve, përkushtimin në punë, punën individuale, në tandem dhe grupe. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informata kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit në realizimin e aktivitetit/detyrës dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ).

Për atë qëllim, mësuesi vëzhgon dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga ana e mësuesit apo shokët/shoqet e klasës;
- performanca praktike (p.sh.: grupimi i 2D formave sipas karakteristikave të ndryshme, zgjidhja e problemeve matematikore, lojë digjitale);
- konstruktonet (modelet);
- përgjigjet/zgjidhjet e dhëna në fletoret e punës, fletoret e arsimtarëve etj.;
- detyrat e shtëpisë.

Duke përdorur teknika dhe instrumente të ndryshme vlerësimi (për shembull: lista kontrolli, lista kontrolli me një shkallë vlerësimi etj.) mësuesi bën një vlerësim përmbledhës në formën e një përshkrimi të standardeve të arritura të vlerësimit. Në fund të tremujorit të parë, të gjysmëvjetorit të parë dhe të tremujorit të tretë nxënësit marrin notën përshkruese mikropërmbledhëse dhe në fund të vitit shkollor notën përshkruese përmbledhëse përfundimtare.

Fillimi i impementimit të programit mësimor	Viti 2022/2023
Institicioni/përfaqësues i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
<p>Në pajtim me nenin 30 paragrafi 3 të Ligjit të Arsimit Fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 161/19 dhe 229/20) Ministria e Arsimit dhe e Shkencës miratoi programin mësimor për lëndën Matematikë për klasën e II.</p>	<p>Nr. _____ Data _____</p> <p style="text-align: right;">Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës Milla Carovska</p> <p style="text-align: right;">_____</p>